



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:239737

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05570671

C.nr.8422/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditësit Z.K nga O, i përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare "K.A", me seli në P, ndaj të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, Rr. "Nëna Terezë" nr.36, me objekt kontesti kompensimin e pagave përcjellëse, vlera e kontestit 1,758.00 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 15.04.2024, mori dhe në të njëjtën datë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Z.K nga O, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të kompensimit të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,758.00 €, së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të kësaj procedure.

A r s y e t i m

Paditësi Z.K nga O, përmes përfaqësueses së autorizuar, Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare "K.A", me seli në P, pranë kësaj gjykate me datë 26.10.2021, ka parashtruar padi ndaj të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e pagave përcjellëse. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet se paditësi ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, në vendin e punës "...", deri në momentin e pensionimit. Më tej theksohet se e paditura, edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë, e nënshkruar me datë 12.06.2018, nuk e ka bërë kompensimin e tre pagave përcjellëse pas daljes në pensionim të paditësit, në vlerë të përgjithshme prej 1,758.00 €. Tutje theksohet se edhe përkundër kërkesës së këtui paditësit, drejtuar të paditurës për pagesën e tre pagave shtesë pas pensionimit, e paditura nuk e ka përmbushur këtë obligim, ndërsa paga mujore, sipas palës paditëse dokumentohet nga shërbimi llogaritar i të paditurës, në bazë të së cilës rezulton që

paditësi ka realizuar pagë bruto në shumën prej 586.00 €. Mbi bazën e pretendimit se e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet konform dispozitave nga Kontrata Kolektive Sektoriale dhe Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55 dhe 90), si dhe kontratës individuale, pretendon që për realizimin e kësaj të drejte i është drejtuar Gjykatës kompetente, duke i propozuar Gjykatës që pas administrimit të provave të merr aktgjykim, me të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija dhe detyrohet e paditura që paditësit, në emër të kompensimit të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,758.00 €, së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm. Po ashtu, i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata përmes aktvendimit të dt.23.02.2024, në mbështetje të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurës, në mënyrë që t'i ofrohet mundësia për paraqitjen e përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditësh, në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së.

E paditura përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.07.03.2024, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Filimisht e paditura pretendon se paditësi marrëdhënien e punës e ka ndërprerë sipas marrëveshjes me të paditurën, andaj i njejtë nuk i plotëson kushtet për kompensimin e pagave përcjellëse. Tutje theksohet se e drejta në paga përcjellëse nuk është e përcaktuar me ligj, por këtë e parasheh Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, por jo si të drejtë imperative, duke pretenduar tutje se për shkak të rezultateve afariste, e paditura nuk ka pasur mundësi të implementojë dispozitat e kësaj Marrëveshje, ndërsa në rast se arrihen rezultate të cilat i tejkalojnë objektivat e cekura, atëherë e paditura është e gatshme t'i zbatojë dispozitat e Marrëveshjes së lartëcekur, por tani për tani kjo është e pa mundur. Për fund, theksohet se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015 dhe në bazë të nenit 90 par.4 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, e njejtë mund të lidhet për një periudhë të caktuar në kohëzgjatje prej 3 vjetësh, andaj kjo Marrëveshje nuk është më në fuqi, respektivisht nuk mund të zbatohet në mënyrë prapavepruese. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me rastin e pranimit të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor mbi refuzimin e kërkesëpadiës pa caktuar fare seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës nga neni 399 par.1 dhe 2 të LPK-së, e cila përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija. Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”*

Nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, Gjykatës i rezulton se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën, i punësuar në Divizionin Termocentrali Kosova A. Departamenti i Prodhimit, në vendin e punës "... ". Po ashtu, në bazë të provave materiale rezulton se palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje për ndërprerjen e kontratës së punës, të evidentuar me numër 1151, e dt.22.02.2019, sipas së cilës marrëveshje të njejtit janë dakorduar për ndërprerjen përfundimtare të kontratës së punës nga data 01.03.2019, në referim të dispozitës nga neni 68 të Ligjit të Punës. Fakti se marrëdhënia e punës e paditësit tek e paditura ka përfunduar me datën 28.02.2019, vërtetohet edhe nga kartela e punëtorit, me numër ID 6152, e lëshuar me datë 28.02.2024 nga e paditura.

Fakt vendimtar për tu vërtetuar nga ana e Gjykatës në këtë çështje juridike kontestimore, konsiston në vlerësimin e faktit nëse paditësi ka fituar të drejtën për kompensimin e pagave përcjellëse në raport me palën e paditur, respektivisht nëse ekziston baza ligjore për realizimin e të drejtës së pretenduar.

Fillimisht, Gjykatës i tërhoqi vëmendjen fakti se paditësi, në referatin e padisë, në disa raste i është referuar Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar me datë 12.06.2018, respektivisht nenit 17 par.3 dhe 4 të kësaj Kontrate, duke pretenduar se Kontrata e lartëcekur shërben si akt nga i cili del themelësia e kërkesëpadisë. Gjykata sqaron se meqenëse paditësi nuk rezulton që i takon ndonjë kategori të punonjësve të shëndetësisë, respektivisht nuk ka të themeluar marrëdhënie pune me ndonjë institucion shëndetësor e as nuk ka parashtruar kërkesë ndaj ndonjë institucioni të tillë për realizimin e të drejtës së pretenduar në padi, rrjedh se akti i lartëcekur nuk mund të aplikohet në funksion të vlerësimit të themelësisë së kërkesës në padi në këtë çështje kontestimore.

Në rastin konkret, duhet t'i referohemi Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të lidhur me datë 18.03.2014, me rastin e nënshkrimit nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), e cila Marrëveshje ka gjetur aplikim për periudhën kohore 01.01.2015 - 31.12.2017. Në këtë mënyrë, një periudhë e tillë e vlefshmërisë është në harmoni të plotë me dispozitën nga neni 90 par.4 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, e cila përcakton që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*

Në nenin 1, par.1 ku bëhet fjalë për qëllimin e lidhjes së kësaj Marrëveshje, parashihet që: *"Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm MPKK), është përcaktimi dhe rregullimi më i qartë dhe më i detajuar i të drejtave, përgjegjësive dhe detyrimeve të palëve në këtë Marrëveshje".* Në anën tjetër, neni 2, i cili flet për fushëveprimin e kësaj Marrëveshje, në paragrafin 1 përcakton që: *"Dispozitat e MPKK, obligojnë palët në Marrëveshje në sektorin privat, publik dhe shtetëror (në nivel të përgjithshëm, në nivel të degëve dhe në nivel ndërmarrjeje)."*

Çështja e kompensimit të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit është e normuar me nenin 53 të kësaj Marrëveshje dhe përcakton që: *"I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muajt te fundit."*

Gjykata vlerëson se pikë së pari duhet të zërthehet mënyra e ndërprerjes së kontratës së punës mes palëve ndërgjyqëse në raportin punëdhënës - punëmarrës. Mënyrat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë të përcaktuara në kreun VIII të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, në nenet 67 - 77 të këtij ligji. Marrëveshja për ndërprerjen e kontratës së punës, e evidentuar me numër 1151, e dt.22.02.2019, sipas së cilës marrëveshje palët ndërgjyqëse janë dakorduar për ndërprerjen përfundimtare të kontratës së punës nga data 01.03.2019, bazën ligjore e ka të mbështetur në dispozitën nga neni 68 të Ligjit të Punës. Kjo dispozitë përcakton që: *"Kontrata e Punës mund të ndërpritet me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit. Marrëveshja nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet në formë të shkruar."*

Në anën tjetër, arritja e moshës së pensionimit, paraqet bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore, në kuptim të dispozitës nga neni 67 par.1, pika 1.4 të ligjit të lartëcekur, ku parashihet që: *"Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç."*

Vlerësimi i Gjykatës konsiston në faktin se kemi të bëjmë me dy baza të ndryshme të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ndërsa në rastin konkret ka ardhur në shprehje ndërprerja e marrëdhënies së punës sipas marrëveshjes së përbashkët, në kuptim të nenit 67 të Ligjit të Punës. Mbi këtë bazë, në aspektin e terminologjisë ligjore, kjo formë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nuk mund të kualifikohet si "pensionim", respektivisht palës paditëse nuk mund t'i referohemi si "i pensionuar". Në dritën e këtij konstatimi, meqenëse dispozita e lartëcekur nga neni 53 e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, si parakusht për gëzimin e beneficionit për kompensimin e pagës përcjellëse e përcakton arritjen e pensionimit nga i punësuari, nga kjo rrjedh se paditësi nuk e ka plotësuar kushtin e nevojshëm për të realizuar të drejtën e pretenduar, andaj nuk mund të shërbehet me dispozitën e sipërcekur.

Thënë kjo, nuk duhet anashkaluar edhe një fakt të rëndësishëm: Edhe në rast se do të vinte në shprehje ndërprerja e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, beneficionet e përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, mund të gëzohen vetëm nëse kushti i kërkuar është arritur brenda periudhës kohore 01.01.2015 - 31.12.2017. Në rastin konkret, paditësi ka ndërprerë marrëdhënien e punës me të paditurën nga dt.01.03.2019, pra në një moment kohor kur Marrëveshja e lartëcekur nuk ka qenë në fuqi dhe ka pushuar të prodhojë efekte juridike. Si rezultat i një interpretimi të tillë, Gjykata vlerëson se nga faktet e treguara në padi rezulton që palës paditëse i mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë në këtë çështje juridike dhe bazuar në një bindje të tillë, nuk është fare e nevojshme të caktohet seancë gjyqësore, pasi ndërmarrja eventuale e këtij veprimi nuk do të ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës në raport me themelësinë e kërkesëpadisë.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke

e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.a, me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të kompensimit të pagave përcjellëse me rastin e pensionimit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,758.00 €, së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Vendimin që secila palë ti t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës, nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore nga nenet 450 lidhur me nenin 463.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se pala paditëse e ka humbur kontestin gjyqësor, kurse pala e paditur, si palë gjyqësore nuk i ka kërkuar apo specifikuar shpenzimet lidhur me këtë procedurë.

Mbi bazën e të lartëcekurave, në mbështetje të dispozitave nga nenet 160 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -

C.nr.8422/21, datë 15.04.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.